



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 716

Prishtinë, Dt. 04.03.2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI
Projektpropozimi	Organizimi hapësinor dhe funksional i vendbanimeve me interes të veçantë nacional - zona perëndimore e Komunës së Obiliqit "Spatial and functional organization of settlements with special national interest - western area of Obiliq Municipality"
Kandidati	Demir MJEKU
Mentori	Prof. Asoc. Ferim GASHI
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 30.03.2023 Vendimi nr.: 1447
Vlerësimi i dorëshkrimit Kandidati Demir MJEKU ka paraqitë kërkesën për vlerësim të dorëshkrimit në punimin e temës së diplomës-master, me titull "Spatial and functional organization of settlements with special national interest - western area of Obiliq Municipality". Tema është nga fusha e planifikimit të hapësinor, prandaj paraqet fushë interesi për shkencën dhe shoqërinë, me qëllim që ky territor të jetë sa më funksional, atraktiv dhe i qëndrueshëm për banorët e kësaj hapësire. Qëllimi i hulumtimit të kësaj teme të masterit është të trajtojë organizimin hapësinor dhe funksional të vendbanimeve perëndimore të Obiliqit, duke pasur për qëllim përcaktimin e indikatorëve të ndryshimeve që kanë ndodhur në këto vendbanime nga viti 2004 deri në ditët e sotme. Ky është një periudhë e rëndësishme, pasi vitet pas 2004 kanë sjellë ndryshime të dukshme në shumë aspekte të jetës sociale dhe ekonomike të zonës. Disa nga aspektet që do të shqyrtohen në këtë hulumtim janë: <ol style="list-style-type: none">1. Dukuri dhe procese demografike dhe zhvillimi social: Si janë zhvilluar këto procese gjatë këtyre viteve dhe si kanë ndikuar tek planifikim hapësinor.2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik: Si është përdorur dhe shfrytëzuar potenciali ekonomik i vendbanimeve dhe si mund të orientohet më mirë zhvillimi për të siguruar qëndrueshmërinë në planifikim hapësinor.3. Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve: Si janë zhvilluar shërbimet dhe infrastruktura dhe si është përfshirë komuniteti në këto procese.4. Shfrytëzimi efikas i resurseve natyrore: Si mund të bëhet përdorimi më efikas i	

resurseve natyrore që ka ky rajon për të siguruar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

5. **Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror dhe kulturor-historik:** Çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe kulturor dhe si janë ruajtur vlerat historike të vendbanimeve.

Në fund, përmes këtij hulumtimi, do të nxirren rekomandime për planifikimin hapësinor, si për qeveritë komunale ashtu edhe për ato qendrore, të cilat do të hartojnë planet dhe strategjitë zhvillimore për periudha të caktuara kohore, duke u bazuar në ndryshimet demografike, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ky proces ka për qëllim menaxhimin racional të hapësirës dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe për rritjen e cilësisë së jetesës për komunitetin.

Në këtë temë të masterit, janë përdorur disa metoda kërkimore për të analizuar **Organizimin hapësinor dhe funksional të vendbanimeve në zonën perëndimore të Komunës së Obiliqit**, me interes të veçantë për zhvillimin dhe ndryshimet në këtë rajon. Metodatat e përdora janë:

1. **Metoda historike:** Kjo metodë përdoret për të studiuar zhvillimin e vendbanimeve në këtë zonë duke analizuar faktet kronologjike, shkaku dhe paraqitjes së vendbanimeve dhe pasojat e zhvillimit të tyre. Fokus i veçantë i kësaj metode është analiza e gjenezës dhe transformimeve hapësinore dhe funksionale gjatë dy dekadave të fundit, duke marrë parasysh ndryshimet në infrastrukturë, morfologji dhe funksione ekonomike.
2. **Metoda e vëzhgimit:** Kjo metodë është thelbësore për vëzhgimin e vendbanimeve në terren. Vëzhgimi përfshin analizimin e organizimit hapësinor, ndërtimit të infrastrukturës dhe karakteristikave të objekteve të banimit, si dhe mënyrën se si ndodhin ndryshimet në parcelat, ndërtimet dhe rrjetet e shërbimeve publike.
3. **Metoda statistikore e mbledhjes së të dhënave:** Përdorimi i të dhënave statistike të mbledhura nga entet statistikore dhe institucionet planifikuese komunale mundëson analizën e lëvizjes së popullsisë, ndryshimeve demografike dhe shpërndarjes së aktiviteteve ekonomike në këtë zonë. Kjo metodë ndihmon gjithashtu në klasifikimin e vendbanimeve sipas madhësisë demografike dhe funksionit ekonomik.
4. **Metoda e krahasimit:** Kjo metodë ndihmon në krahasimin e zhvillimeve të vendbanimeve gjatë periudhave të ndryshme kohore, për të identifikuar ndryshimet dhe përparimet në organizimin hapësinor dhe funksional të kësaj zone, veçanërisht në aspektin morfologjik, demografik dhe ekonomik.
5. **Metoda e klasifikimit:** Klasifikimi i vendbanimeve sipas morfologjisë, madhësisë demografike dhe funksionit ekonomik është i rëndësishëm për të kuptuar diversitetin e strukturës së vendbanimeve dhe zhvillimin e tyre të ardhshëm.
6. **Metoda analizës së të dhënave:** Kjo metodë synon analizimin e të dhënave të mbledhura për të zbuluar lidhjet dhe tendencat në zhvillimin e vendbanimeve, si dhe për të identifikuar faktorët që ndikojnë në ndryshimet hapësinore dhe funksionale të kësaj zone.
7. **Metoda e sintezës së të dhënave:** Pas analizës së të dhënave, kjo metodë përdoret për të integruar informacionin dhe për të krijuar një kuptim të plotë dhe të saktë mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit të vendbanimeve në zonën perëndimore të Komunës së Obiliqit.

Ky hulumtim i kushton vëmendje të veçantë organizimit hapësinor dhe funksional të vendbanimeve me interes të veçantë kombëtar dhe ka treguar se planifikimi dhe menaxhimi efektiv i këtyre zonave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e identitetit të këtyre zonave dhe banorëve të saj. Nëpërmjet analizës së faktorëve hapësinorë, historikë, ekonomikë dhe socialë, është evidentuar se vendbanimet e tilla përballen me sfida të shumta, si urbanizimi i pakontrolluar, mungesa e infrastrukturës adekuate dhe presionet demografike.

Organizimi hapësinor dhe funksional i vendbanimeve të komunës së Obiliqit ka rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik dhe energjetik të Kosovës, si dhe për sfidat e mëdha që kanë këto vendbanime për shkak të aktivitetit industrial, veçanërisht termocentraleve.

Ndikimi i industrisë energjetike – termocentraleve dhe minierave të qymyrit – ka ndikuar në strukturën hapësinore të komunës, duke krijuar zona të ndotura dhe duke kufizuar zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomikë. Mungesa e planifikimit të qëndrueshëm, pavarësisht rëndësisë strategjike, ka bërë që këto vendbanime të përballen me mungesë investimesh në infrastrukturë moderne, gjelbërim dhe shërbime të tjera publike. Banorët e kësaj zone përballen me probleme të ndotjes së ajrit dhe degradimit të tokës, çka ndikon në shëndetin dhe migrimin e popullsisë drejt zonave më të pastra dhe më të zhvilluara.

Përveç sektorit energjetik, Obiliqi ka mundësi për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, turizmit industrial dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës përmes projekteve të reja urbane dhe mjedisore. Në këtë zonë nevojitet një qasje e re në organizimin hapësinor dhe funksional, ku zhvillimi industrial të mos vijë në kurriz të mirëqenies së qytetarëve dhe mjedisit. Zbatimi i politikave të qëndrueshme dhe investimi në urbanizim më të planifikuar do të sigurojnë që këto vendbanime të mbeten një qendër e rëndësishme energjetike, por edhe një vend me kushte më të mira për jetesë dhe zhvillim afatgjatë.

Zhvillimi hapësinor i këtyre vendbanimeve të komunës së Obiliqit ka një rëndësi të veçantë kombëtare për shkak të prodhimit të energjisë. Planifikimi i saj hapësinor dhe funksional kërkon një qasje më të balancuar mes zhvillimit industrial dhe mirëqenies së banorëve. Ky zhvillim do të arrihet përmes hartimit të një plani të integruar hapësinor dhe zhvillimor, i cili do të balancojë nevojat industriale me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm të kësaj zone me interes kombëtar. Investimet në infrastrukturë publike dhe mjedisore, si përmirësimi i rrugëve, shërbimeve komunale dhe krijimi i hapësirave të gjelbra për banorët, janë të domosdoshme. Gjithashtu, monitorimi më i rreptë i ndikimeve mjedisore nga termocentralet dhe aplikimi i teknologjive më të pastra për reduktimin e ndotjes janë të rëndësishme.

Diversifikimi ekonomik, për të krijuar mundësi të reja punësimi jashtë sektorit energjetik dhe për të rritur cilësinë e jetesës së banorëve, është gjithashtu një hap i rëndësishëm. Po ashtu, përfshirja e komunitetit lokal në proceset vendimmarrëse do të sigurojë që zhvillimi i vendbanimeve të komunës së Obiliqit të jetë i orientuar drejt nevojave të banorëve dhe jo vetëm të industrisë energjetike.

Fillimisht, kemi mbledhur burimet e të dhënave, literaturës dhe vëzhgimet nga terreni për të arritur te konkluzionet e synuara. Këto burime të dhënash janë realizuar me anë të metodave të ndryshme, të cilat na kanë çuar në përfundime të ndryshme.

Në kapitullin e dytë kemi trajtuar organizimin dhe marrëdhëniet në sistemin e vendbanimeve, si dhe kuptimin dhe klasifikimin e tyre hapësinor dhe funksional. Në kapitullin e tretë janë trajtuar veçoritë fiziko-geografike, ndikimi i faktorëve natyrorë si morfologjia e relievit, pasuritë natyrore, klima, ujërat dhe bota e gjallë në shtrirjen e këtyre vendbanimeve, si dhe ndikimet e këtyre faktorëve në aspektin social dhe ekonomik.

Në kapitullin e katërt është trajtuar planifikimi i zhvendosjes së një pjese të vendbanimeve që shtrihen në zonën me interes të veçantë kombëtar, në periudha të ndryshme kohore, në bazë të strategjive dhe vendimeve të marra nga qeveria e Kosovës. Janë trajtuar procedurat dhe mënyrat e zhvendosjes së banorëve të kësaj zone, ndikimet e këtyre vendimeve në morfologjinë e vendbanimeve, aspektin social-ekonomik, pasojat e humbjes së tokës bujqësore, ndikimi në mjedisin jetësor (si ndotja e ajrit, tokës dhe ujit) dhe ndikimet psikologjike dhe emocionale të banorëve si rezultat i largimit nga vendbanimet e tyre.

Në kapitullin pasues janë trajtuar ndryshimet në madhësinë demografike, kalimi i tyre në

kategori më të vogla demografike dhe pasojat sociale në mungesën e shërbimeve të nevojshme për banorët. Përveç kësaj, është trajtuar humbja e rëndësisë funksionale të këtyre vendbanimeve si rezultat i procesit të zhvendosjes. Nga faktori i zhvendosjes kanë pasur ndikime edhe aspektet e zhvillimit ekonomik, si mungesa e investimeve në zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, mungesa e investimeve në infrastrukturën e objekteve publike dhe sociale (si shkolla, qendra shëndetësore, qendra rekreative e sportive, zyra administrative, etj.). Ky proces ka pasur ndikime në infrastrukturën teknike. Si rezultat i zgjerimit të minierës sipërfaqësore, edhe ato pak rrugë të rëndësishme për këto vendbanime janë shkatërruar dhe kanë humbur rolin funksional lidhës mes tyre, si dhe në aspektin rajonal. Ka pasur mungesa të investimeve komunale në infrastrukturën e zgjerimit të ujësjellësit, kanalizimit, sistemit të ujitjes, elektrifikimit dhe infrastrukturës rrugore, gjë që ka ndikuar në domosdoshmërinë e zhvendosjes së pjesës tjetër të popullatës në të ardhmen, si rezultat i mungesës së faktorëve socio-ekonomikë dhe infrastrukturorë të nevojshëm për jetesë.

KONKLuzioni DHE PROPOZIMI

Në përfundim të vlerësimit të dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit **Demir MJEKU**, me titull "**Organizimi hapësinor dhe funksional i vendbanimeve me interes të veçantë nacional - zona perëndimore e Komunës së Obiliqit (Spatial and functional organization of settlements with special national interest - western area of Obiliq Municipality)**", mund të nxirren këto konkluzione kryesore:


1. **Tematika e përzgjedhur** për këtë tezë është origjinale dhe i kushtohet një analize të thelluar të një hapësire dhe periudhe kohore që është relativisht pak e trajtuar në literaturën gjeografike dhe në atë të planifikimit hapësinor. Kjo temë paraqet një kontribut të vlefshëm në fushën e studimit të organizimit hapësinor dhe funksional të vendbanimeve, duke trajtuar një zonë të caktuar, të rëndësishme për zhvillimin urban dhe rural në këtë sektor të Kosovës.
2. **Përdorimi i të dhënave dhe metodologjisë** është në përputhje me standardet shkencore, duke siguruar një analizë të detajuar të zhvillimeve hapësinore dhe funksionale përgjatë periudhës kohore të shqyrtuar. Të dhënat e grumbulluara dhe të analizuar, si dhe format e ndryshme grafike të përpiluara për këtë hapësirë, jo vetëm që kanë një vlerë të lartë shkencore, por janë gjithashtu të dobishme për praktikën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj zone. Këto të dhëna ofrojnë një bazë solide për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve, si dhe për krijimin e strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetur në vlerësimet dhe konkluzionet e mësipërme, Komisioni profesional ka vlerësuar se punimi i masterit të kandidatit **Demir MJEKU**, me titull "**Organizimi hapësinor dhe funksional i vendbanimeve me interes të veçantë nacional - zona perëndimore e Komunës së Obiliqit (Spatial and functional organization of settlements with special national interest - western area of Obiliq Municipality)**" i plotëson të gjitha kërkesat formale, juridike dhe shkencore-profesionale për të kaluar në procedurat e mëtejshme të shqyrtimit dhe miratimit të kësaj teze. Ky punim është një kontribut i rëndësishëm në fushën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe është një shembull i shkëlqyer i përdorimit të metodologjive moderne për studimin e hapësirave urbane dhe rurale.


Prishtinë, 03.03.2025

Komisioni:


1. Prof. Asoc. Ibrahim RAMADANI- kryetar



2. Prof. Asoc. Ferim GASHI - anëtar



3. Prof. Dr. Arsim EJUPI anëtar



P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.